



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:019810
Datë: 07.08.2024
Numri i dokumentit: 06027912

K.Dh.Shk II.nr.474/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit Raiffesien Bank Kosovë (RBKO) Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Robert Doll”, nr. 99, kundër debitorëve G.B. B.I., me numër unik identifikues 811397167, me pronar G.B. me numër personal dhe adresë në Gjakovë, përfaqësuar sipas autorizimit Yll Bokshi., avokat nga Gjakova, si dhe P.Sh. me numër personal ..., me adresë në Prishtinë, Matiqan, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1489/23 të datës 17.01.2024, me datë 07.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Raiffesien Bank Kosovë (RBKO) Sh.A., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1489/24 të datës 17.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.1489/24 të datës 17.01.2024, ne dispozitiv të aktvendimit ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit G.B. B.I., me numër unik identifikues 811397167, përfaqësuar nga pronari G.B. ashtu që Urdhri Përmbarrimor P.nr. 286/2023, i lejuar me datë 01.08.2023, nga Përmbarruesi Privat Fadil Hoxha, është shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë kreditori (*me pretendime sikur në ankesë*) duke kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të anuloj vendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1489/24 të datës 17.01.2024, dhe të bie vendim që edhe njëherë të shqyrtohet lënda në gjykatë. Mbi arsyet e lartcekura ka kërkuar nga gjykata të vendos si në propozimin e lartpërmendur.

Debitori ka ushtruar përgjigje ne ankesë nëpërmjet së cilës ka theksuar se kontrata e prezantuar nga nuk është akt i përmbarrueshëm, andaj gjykatës së shkallës së dytë i ka propozuar që ankesën e kreditorit ta refuzoj si të pabazuar.

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Raiffeisen Bank Kosovë (RBKO), me seli në Prishtinë, ka parashtruar propozimin për përmbarrim mbi bazën e dokumentit përmbarrimor: Marrëveshjes mbi Pengun për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshjes mbi kredinë nr. 200734123, e datës 28.06.2022, e regjistruar në regjistrin publik sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20220629-627, të datës 29.06.2022, ka nxjerr Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 286/2023, të datës 01.08.2023, me të cilin është lejuar përmbarrimi ndaj debitorëve për realizimin e borxhit në shumë prej EUR 27,414.45 me kamatë të rregullt dhe kamatëvonesë, përfshi edhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore, përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorëve dhe bartjen e mjeteve në llogari të kreditorit apo përmes sekuestrimit të kolateralit të lënë peng dhe shitjes me qëllim të realizimit të kredisë së kreditorit.

Debitori G.B. B.I., brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarrimor, me arsyetim se marrëveshja mbi kredinë nuk përbën dokument

përmbartimor ngase vetëm kontrata e përpiluar në formë të aktit noterial mund të përmbartohet në kuptim të dispozitave të LPP-së, ndërsa ka shtuar se borxhi i pretenduar i kreditori nuk është i bazuar në prova, andaj edhe propozimi për përmbartim është në kundërshtim me nenin 71, pika 1.1 të LPP-së. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta aprovoj si të bazuar ashtu që urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe se nuk gjen mbështetje në nenin 71 të LPP-së dhe se debitorët nuk ka ofruar prova në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së, për ti mbështetur pretendimet e paraqitura në prapësim. Ndërsa, ka shtuar se propozimi për përmbartim i plotëson kushtet nga neni 38 të LPP-së, dhe se organi përmbartimor ka lejuar urdhrin mbi bazën e marrëveshjes mbi pengun e cila përbën dokument përmbartimor në kuptim të nenin 22, paragrafi 1, pika 1.7 a), të LPP-së, ngase e njejta është e regjistruar pranë regjistrit zyrtar të pengut. Në fund, ka theksuar se lartësia e borxhit të kërkuar për përmbushje është e saktë dhe se bazohet në marrëveshjen mbi kredinë e lidhur mes palëve. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin, përgjigjes në prapësim dhe shkresave në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1489/23 të datës 17.01.2024, me të cilin në dispozitiv të aktvendimit ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit G.B. B.I., me numër unik identifikues 811397167, përfaqësuar nga pronari G.B. ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 286/2023, i lejuar me datë 01.08.2023, nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha, është shfuqizuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se dokumenti, përkatësisht Marrëveshja mbi Pengun për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshjes mbi kredinë nr. 200734123, e datës 28.06.2022, e regjistruar në regjistrin publik sipas Konfirmimit mbi regjistrimit e pengut me R-20220629-627, të datës 29.06.2022, e mbi bazën e së cilës është paraqitur propozimi për përmbartim nga ana e kreditorit dhe është lejuar urdhri përmbartimor nga ana e përmbartuesit privat, nuk është deponuar në origjinale apo kopje të vërtetuar siç kërkohet me nenin 38 të LPP-së.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se baza juridike për caktimin e përmbarimit, kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të caktuar përmbarimin sipas dokumentit të përmbarimit, parashihen sipas dispozitës së nenit 22 par.1 nën par 1.7 dhe me nenin 5 par.2 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore, Ligjit për Procedurën Përmbarimore, nr.05/L-118 të, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore ku në mesin e dokumenteve përmbarimore në bazë të cilave organi përmbarues mund të caktoj përmbarimin është kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit si dhe edhe kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut.

Sipas nenit 27, paragrafi 1 të LPP-së, është përcaktuar se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Tutje, sipas nenit 38, paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, *Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit. 2. Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.*

Gjykata Komerçiale, dhoma e shkallës së dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejtë se, dokumentet në bazë të cilave është iniciuar procedura përbarimore nuk janë në origjinal apo kopje të vërtetuar dhe rrjedhimisht të njëjtat nuk mund të konsiderohen si dokumente të besueshme për përbarim në kuptim të dispozitës së lartcekura, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e shkallës së dytë ka analizuar edhe pretendimet tjera të kreditorit por të njëjta mbasin vetëm në natyrën deklarative dhe të pambështetura në prova konkrete siç parasheh dispozita 69 par.4 të LPP dhe si të tilla nuk janë relevante për vendosje ndryshe prandaj kanë rezultuar si të pathemelta të cilat gjykata ankimore vendosi të refuzojë ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi ta vërtetojë.

Përndryshe, në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.474/24. me datë 07.08.2024

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**